



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031 - 304439, më 15. 12. 2016

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 53 i Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, sipas detyrës zyrtare nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR EVIDENTIMIN E SHFRYTËZUESVE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE PARA OBJEKTEVE AFARISTE-HOTELIERE PËR SEZONIN DIMËROR

I

Formohet komisioni për evidentimin e shfrytëzuesve të hapësirave publike para objekteve afariste-hoteliere për sezonin dimëror.

II

Komisioni i cekur në pikën I të këtij Vendimi është në këtë përbërje:

1. Enver Kadriu, kryesues,
2. Sabri Gashi, anëtar,
3. Skënder Gashi, anëtar dhe
4. Menduh Halili, anëtar.

III

Detyra e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë: të mbledhë të gjitha të dhënat e domosdoshme dhe të bëjë matjen, kalkulimi- faturimin dhe dhënien e pëlqimeve për shfrytëzuesit që i plotësojnë kriteret e parapara sipas Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-157481, dt. 1.7.2014, lidhur me shfrytëzimin e hapësirave nga subjektet afariste.

IV

Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni do ti raportoj Kryetarit të Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti